



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 23 Datë 10. 04. 2017

**“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË REZERVËS UJORE PËR ENERGJI
ELEKTRIKE”- SUBJEKTIT “PALUSHI”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pika 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”,të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni” , me propozim të A.B.U Drin- Bunë , miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore , pas shqyrtimit te dokumentacionit perkates , Keshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

Vendosi:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “**PALUSHI** ” me administrator Z.Meriman PALUSHI , për përdorim të rezervës ujore **Përroi Tershanes , dege e perroit te Bicajt** , degë të Lumit Drin i Zi , për prodhim energjie elektrike në fshatin Bicaj , Njësia Administrative Bicaj ,Bashkia Kukës , Qarku Kukës .
Sipas studimit të paraqitur nga subjekti , objekti HEC GJALLICA do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes Nr1: X1 – 44 54 120 ; Y1 – 46 50 260 ; Z1 – + 800 m

Koordinatat e godinës së centralit: X – 44 52 230 ; Y – 46 50 970 ; Z – + 470 m

Koordinatat e pikes së shkarkimit : X – 44 52 230 ; Y – 46 50 970 ; Z – + 470 m

Prurja mesatare e përroit: $Q_{1\text{mes}} = 0.504 \text{ m}^3/\text{sek}$;

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: $Q_{\text{llog}} = 0.720 \text{ m}^3/\text{sek}$;

Prurja ekologjike: $Q_{\text{ekol}} = 0.106 \text{ m}^3/\text{sek}$;

Prurja që shkarkohet: $Q = 0.720 \text{ m}^3/\text{sek}$.

2- Autorizimi i përdorimit të rezerves ujore për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETARI
Martin PLLUMBI



KRYETARI
Paulin RADOVANI